



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:274302

Datë: 14.11.2024

Numri i dokumentit: 06453707

K.DH.SH.II.nr.1570/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Faton Bajrami, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Auto Sherreti shpk me numer identifikues 810659039 me seli në Ferizaj, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditues të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.340/22 të datës 13.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.11.2024, merr këtë:

#### A K T V E N D I M

Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.340/22 i dates 13.06.2024, Anulohet, dhe Lënda i kthehet të njëjtës Gjykatë, në rigjykim dhe rivendosje.

#### A r s y e t i m

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me aktgjykimin e atakuar. në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet si e bazuar Kërkesëpadia e paditësit Auto Sherreti shpk me seli në Ferizaj, II. Anulohet Aktvendimi nr.01.3.2.2/4288/2019 dt.05.11.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, III. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit, Auto Sherreti shpk, t'ia kthej shumën prej 7,707.11€, të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlersimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore

R-5510/11.03.2019, R-5514/11.03.2019, R-5515/11.03.2019, R-5519/11.03.2029, R-5521/11.03.2019, R-5532/11.03.2019, R-6021/16.03.2019, R-6025/16.03.2019, R-6116/18.03.2019, R-6118/18.03.2019, R-6785/25.03.2019, R-7625/02.04.2019, R-7619/02.04.2019 dhe R-7610/02.04.2019 të ZBD Interevropa, me kamatë ligjore prej 8% nga data 27.09.2019 deri në pagesën definitive, IV Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura me të cilin e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; shkeljes se dispozitave të LPK-së, zbatimit të gabuar të drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje esenciale të dispozitave te procedures, me propozim që të aprovon ankesën në tërësi si të bazuar në ligj, të prish Aktgjykimin KF.nr.340/22 i datës 13.06.2024 si të pa bazuar në ligj, ta Refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar me ligj dhe ta lë në fuqi aktvendimin e kontestuar, ose t'ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar, si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 49 i LKA-së, në drejtim të theksimeve në ankesë, përgjigjes në ankes, dhe pas shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura, në rivendosje, me aktvendimin nr. 01.3.2.2/4288/2019 të datës 05.11.2021, e ka Refuzuar kërkesën e e subjektit në procedurë paditësit Auto Sherreti shpk me seli në Ferizaj, për rishqyrtimin e vendimeve R-5510/11.03.2019, R-5514/11.03.2019, R-5515/11.03.2019, R-5519/11.03.2029, R-5521/11.03.2019, R-5532/11.03.2019, R-6021/16.03.2019, R-6025/16.03.2019, R-6116/18.03.2019, R-6118/18.03.2019, R-6785/25.03.2019, R-7625/02.04.2019, R-7619/02.04.2019 dhe R-7610/02.04.2019 të ZBD Interevropa,, si të pabazuar.

Paditësi, i pa kënaqur me vendimin e lartcekur ka ushtruar padi në konflikt administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e vendimit të saj dhe kërkon që i njëjti të anulohet si jo ligjor.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të lart cekur, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor

dates 13.06.2024, e duke u bazuar edhe ekspertizën financiare, bie Aktgjykimin e ankimuar me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit, jepen vlersimet faktike dhe juridike të gjykates, se nga provat e administruara në këtë konflikt administrative gjykatës i rezultoi një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur. Gjykata vleron se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale e ka rivlersuar mallin e deklaruar për zhdoganim nga paditësit sipas DUD-ave kontestues, Gjykata ka pranuar ekspertizën financiare datës 14.04.2024 në tërsi si të besueshme, e argumentuar mirë në raport me detyrat. Gjykata konstatoi se aplikimi i metodës 6 të vlersimit nga neni 35 i KDAK-së, është veprim që bie ndesh me dispozitat e nenit 33-35 të KDAK-së, për arsye se para se të aplikohet metoda e fundit e vlersimit, duhet të jepen arsyet dhe provat për ta kontestuar vlerën e mallit. Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur fatura të mallit lëndor, të cilat janë paguar përmes urdherpagesave bankare me status të aprovuar, të harmonizuara në kuptim të shumës së bërë. Gjykata i vleroi tërsisht të bazuara pretendimet e paditësit dhe se dokumentacioni është i pakontestueshëm nga pikpamja ligjore, konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes dhe duke shqyrtuar vendimet e organit të paditur, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjen se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (n) të LPK-së, dhe si tillë është jo i plotë.

E paditura në ankesën e saj kundër aktgjykimit ankimor, ka potencuar se gjykata e shkallës së parë i ka fal besimin ekspertizës financiare, e cila nuk ka harmonizuar transaksionet bankare me faturat e mallit kontestues, duke konkretizuar mosharmonizimet që eksperti financiar i ka cekur në faqen 8 të ekspertizës, numri rendor 6 dhe 7 përkitazi me DUD-at R-5515/11.03.2019 dhe R5532/11.03.2019, dhe disa faturat, nga të cilat nuk dihet se malli i zhdoganuar është eksportuar/importuar, me këto fatura.

Dhomat e shkallës së dytë, gjatë vlerësimit të provave në lëndë, të cilat i ka administruar dhe cekur në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, konstatohet se në seancën gjyqësore datës 13.06.2024, perfaqësuesi i të paditurit konteston në mënyrë të përgjithshme harmonizimin e transaksioneve të importeve të paditësit, pa i evidentuar të metat e ekspertizës financiare datës 14.04.2024 konkretisht se cilat transaksione dhe fatura nuk harmonizohen në kuptim të vlerës së

mallit lëndor, nuk kërkohet sqarim për këto moharmonizime financiare nga eksperti financiar, porse në fund përfaqësuesi i autorizuar i paditurit, deklaroi se vlera e kontestit sipas të paditurit është 7,707.11€.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, nga shkresat e lëndës vëren se në ekspertizën financiare datës 14.04.2024, në faqen 8 rubrika 6 dhe 7, janë përfshirë respektivisht kalkular edhe vlera e faturës nr.FR205272 (DUD-i R-5515), faturave nr.V0005961, VO005799, VO005800 (DUD-i 5532), ku nga shkresat e lëndës, nuk është e qartë se është bërë deklarimi i zhdoganimit të mallrave me këto fatura.

Kolegji konsideron, se nuk është sqaruar mjaftueshëm në ankes nga i padituri as nga paditësi në anën tjetër, se vlera e këtyre faturave kontestuese, ndikojnë në vlerën e borxhit kryesor në emër të rivlersimit të mallit doganor. Andaj në rastet e tilla kur kemi paqartësi dhe mos harmonizime të dokumentacionit të mallit lëndor, gjykata e shkallës së parë ka pasur obligim të shqyrtoj me kujdes dispozitat e legjislacionit doganor, si dhe të gjitha provat e administruara që kanë ofruar palët ndërgjyqëse, ashtu që nga ballafaqimi i provave të nxjerra gjatë konfliktit administrativ, përmes ekspertizës financiare, të nxjerr konkluzion të drejt sa i përket kontestit të vlerës së saktë, në drejtim të detyrimit të pagesave detyimore doganore.

Për arsyet e dhëna më lartë, aktgjykimi i kundërshtuar është dashur të priset, dhe çështja ti kthehet Dhomave të shkallës së parë në rigjykim, për ti mënjeluar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (n) të LPK-së, që janë të atilla që pengojnë vlersimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të goditur.

Në ri procedurë Dhomat e shkallës së parë, duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga Kolegji i kësaj gjykate, të shqyrtoj me kujdes dispozitat e legjislacionit doganor, si dhe provat e ofruara nga palët ndërgjyqëse. Dhomat e shkallës së parë sipas nevojës dhe kërkesave të palëve ndërgjyqëse, të siguroj prova shtesë përmes plotësimit të ekspertizës financiare, me qëllim të konstatimit të saktë të vlerës së paguar të detyrimeve doganore, për shkak të rivlersimit të mallit, përmes DUD-ave kontestues, dhe në fund të vlersoj se paditësi ka paraqitur dokumentacion të duhur, në vështrim të nenit 33 Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1570/24 me datë 08.11.2024

Kryetar i kolegjit,

Krenar Berisha